

Shpenzimet e organizatave buxhetore për **vendimet gjyqësore**



Shpenzimet e organizatave
buxhetore për vendimet
gjyqësore

Mars 2023

— Përmbajtja

Shpenzimet e organizatave buxhetore për vendimet gjyqësore	3
1. Detyrimet kontingjente	4
2. Pagesat për vendime gjyqësore	4
Obligimet e papaguara dhe rezerva rrjedhëse	11
Përfundim	13

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është përgaditur me kërkesë të UNDP-së, përmes projektit Mbështetje në Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë (SAEK) III, me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), për të promovuar transparencën institucionale dhe buxhetore dhe llogaridhënien. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së në Kosovë, SDC dhe SIDA.

Mbështetur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden
Sverige

Shpenzimet e organizatave buxhetore për vendimet gjyqësore

Pagesat e institucioneve publike në Kosovë për vendimet gjyqësore dhe përmbartimore janë rritur ndjeshëm përgjatë viteve. Thesari i Kosovës, duke u bazuar në vendimet e gjykatave për vitin 2022, ka realizuar pagesa nga buxheti i organizatave buxhetore në vlerë 46.3 milionë euro. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2022, pagesat janë ulur për rreth 5.6 milionë euro apo për (-11%).¹ Ndërkaq, shuma e padive gjyqësore drejtuar institucioneve publike për vitin 2022 ishte 347 milionë euro apo rreth 110 milionë euro më shumë se në vitin 2021.² Në periudhën 2017–2022, organizatat buxhetore kanë paguar mesatarisht 31 milionë euro në vit për vendime gjyqësore dhe përmbartimore. Në total në gjashtë vitet e fundit janë shpenzuar afër 186 milionë euro pagesa pas vendimeve gjyqësore. Bazuar në gjetjet nga raportet e auditimit të njëmbëdhjetë organizatave buxhetore të vitit 2021, të cilat e përbëjnë 76% të gjithsej pagesave për vendimet gjyqësore dhe përmbartimore, çështjet të cilat i shkaktojnë më së shpeshti këto padi dhe pagesa kryesisht kanë të bëjnë me procese të shpronësimit, paga jubilarë dhe vonesa në pagesa të faturave. Për çështje të shpronësimit janë paguar 7.4 milionë euro në vendime gjyqësore, për paga jubilarë janë paguar mbi 12.7 milionë euro, kurse për çështje të vonesave të pagesës së faturave janë paguar rreth 11.5 milionë euro, nga të cilat 9.5 milionë euro për vonesat që kanë të bëjnë me kategorinë e investimeve kapitale dhe rreth 2 milionë euro për vonesa që kanë të bëjnë me kategorinë mallra dhe shërbime.³

Secilin vit, Ligji për buxhet parasheh ndarje buxhetore për zbatimin e vendimeve nga autoritetet përmbartimore në kuadër të kategorisë rezerva rrjedhëse. Por, për shkak të vlerës së lartë të obligimeve të institucioneve, Thesari në shumë raste i tërheq fondet e lira nga kategori të ndryshme buxhetore të institucionit. Gjatë periudhës 2017–2022, për kategorinë e rezervës rrjedhëse, mesatarisht janë buxhetuar 17.2 milionë euro në vit. Këto mjete buxhetore të kësaj kategorie, me aprovim nga zyrtarët përgjegjës, mund të barten edhe në kategori tjera, sikurse ajo e shpenzimeve kapitale.

Marrë parasysh këtë, dëmet të cilat i shkaktohen buxhetit të institucioneve prej vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore janë të shumta. Përveç shpenzimeve të interesit që detyrohen të paguajnë institucionet, në këto raste pamundësohet ose shtyhet edhe realizimi i projekteve të planifikuara, rrezikohen projektet e reja, dëmtohen operatorët e përgjegjshëm ekonomik, etj. Përmes kësaj memo të politikave, Instituti GAP synon të pasqyrojë shpenzimet e organizatave buxhetore për vendimet gjyqësore, çështjet dhe arsyet të cilat i shkaktojnë këto shpenzime viteve të fundit. Gjithashtu, në fund të memos jepen edhe përfundime.

1 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Raporti vjetor financiar 2022. Burimi: <https://bit.ly/42P0I7Y>


2 Ibid.

3 Zyra Kombëtare e Auditimit .Raportet e auditimit për pasqyrat financiare vjetore 2021 të: Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar, Komunës së Ferizajt, Prizrenit, Mitrovicës së Jugut, Prishtinës, Gjakovës, Malishevës, Pejës dhe Deçanit. Burimi: <http://bitly.ws/BfKG>

1. Detyrimet kontingjente

Detyrimet kontingjente janë shuma që një institucion publik (organizatë buxhetore) rrezikon t'i shpenzojë me vendime të gjykatave, për shkak të padive nga operatorët ekonomikë apo personat fizik. Sipas Raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), detyrimet kontingjente për organizatat buxhetore në vitin 2022 ishin 347 milionë euro. Krahasuar me vitin 2021, detyrimet kontingjente në vitin 2022 janë rritur për 46% apo rreth 110 milionë euro. Organizatat me detyrime kontingjente më të larta janë Komuna e Prishtinës me 79.6 milionë euro, Këshilli Gjyqësor i Kosovës me 76.8 milionë euro, Ministria Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me 37.3 milionë euro, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore me rreth 30 milionë euro, Komuna e Gjilanit me 17.7 milionë euro, Ministria e Punëve të Brendshme me rreth 12 milionë euro, Prokurori i Shtetit me 9.7 milionë euro.⁴

Figura 1. Detyrimet kontingjente të institucioneve publike (2017–2022)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat nga Raportet e MFPT-së


2. Pagesat për vendime gjyqësore

Në vitet e fundit, konkretisht në periudhën 2017–2022, organizatat buxhetore kanë paguar mesatarisht 31 milionë euro në vit për vendime gjyqësore dhe përmbartimore⁵. Pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore përgjatë këtyre viteve janë rritur ndjeshëm, veçmas në periudhën 2018–2021. Në vitin 2018, bazuar në vendimet e gjykatave, Thesari i Kosovës nga buxheti i organizatave buxhetore ka paguar 20.3 milionë euro, apo 76% më shumë se në vitin 2017. Ndërsa, në vitin 2021, këto pagesa kanë arritur në rreth 52 milionë euro, apo 22 milionë euro (+73%) më shumë se në vitin 2020 dhe 40.4 milionë euro (+350%) më shumë se në vitin 2017.⁶ Ndërsa, në vitin e fundit (2022) pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore vërehet se kanë rënë për 5.6 milionë euro apo (-11%).

⁴ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Raporti vjetor financiar 2022. Burimi: <https://bit.ly/42P0I7Y>


⁵ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Raportet vjetore financiare (2019–2022). Burimi: <https://bit.ly/40KecOz>

⁶ Zyra Kombëtare e Auditimit. Raportet Vjetore. Burimi: <https://bit.ly/3IGsbrj>; <https://bit.ly/3SbLGnC>; <https://bit.ly/3EmIiIP>

Figura 2. Pagesat e vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore (2017–2022)

Burimi: Instituti GAP, bazuar në raportet e MFPT


Sipas raportit vjetor financiar 2021 të MFPT⁷, organizatat buxhetore me pagesa më të larta për vendimet gjyqësore dhe përmbartimore janë: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) me 7.5 milionë euro, Komuna e Ferizajt me 7 milionë euro, Komuna e Prizrenit me rreth 5 milionë euro, Komuna e Mitrovicës së Jugut me 4.3 milionë euro, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) me rreth 3.3 milionë euro, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) me 2.9 milionë euro, e kështu me radhë. Njëmbëdhjetë nga 74 organizata buxhetore kanë paguar nga mbi një milion euro secila përmes vendimeve të gjykatave dhe përmbartimit, ndërsa 61 organizata të tjera buxhetore kanë paguar më pak se një milion euro.

Figura 3. Pagesat me vendim të gjykatave dhe përmbartimeve (2019–2022)

Burimi: Instituti GAP, bazuar në raportet e ZKA-së

7 MFPT. Raporti vjetor financiar 2021. Burimi: <https://bit.ly/414KMgY>

Figura 4. Pagesat për vendimet gjyqësore dhe përmbarimit të disa prej organizatave buxhetore



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat nga raportet e MFPT

Bazuar në raportet e auditimit për pasqyrat financiare për vitin 2021, çështjet të cilat i shkaktojnë këto pagesa kryesisht kanë të bëjnë me procese të shpronësimit, paga jubilarë dhe vonesa në pagesa të faturave.⁸

Ndikim në vlerën e lartë të pagesave për vendime gjyqësore dhe përmbarimore del të ketë edhe përfaqësimi jo i duhur nga përfaqësuesit ligjorë të institucioneve publike. Në raste, përfaqësuesit e institucioneve publike nga Avokatura Shtetërore nuk ka marrë fare pjesë në seanca gjyqësore, duke mos e mbrojtur kështu interesin e institucioneve publike. Për shembull, në një rast gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte aprovuar kërkesën e një kompanie farmaceutike kundër Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), 11 vjet pasi MSh e kishte eliminuar këtë kompani nga tenderi për furnizim barnash të caktuara. Në seancën e shqyrtimit nuk ishin paraqitur as përfaqësuesi ligjor i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP-së) e as ai i MSh-së, si dhe ata nuk i kanë dorëzuar gjykatës provat relevante. Deri në një vendim në shkallën tjetër, borxhi aktual prej 636 mijë eurosh do të rritet për tetë për qind për çdo vit vijues, nëse shkalla e dytë nuk e aprovon ankesën e Ministrisë së Shëndetësisë.⁹

Arsye të tjera që kanë ndikur në rritjen e pagesave gjyqësore dhe përmbarimore janë edhe planifikimi i dobët buxhetor i aktiviteteve të projekteve kapitale, vonesat në pagesa të faturave të rregullta, mosrespektimi i kushteve të kontratave, ndërprerjet e njëanshme të kontratave, inflacioni, pandemia COVID-19, etj.

Kur në kushtet e kontratës është kriter çmimi më i ulët për ofertues, ndërsa fitues shpallen ofertuesit që nuk e plotësojnë këtë kriter, ofertuesit me çmimin më të ulët me të drejtë mund të ushtrojnë padi ndaj institucionit dhe të fitojnë rastin.

⁸ Zyra Kombëtare e Auditimit. Raportet e auditimit për pasqyrat financiare vjetore 2021 të: Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar, Komunes së Ferizajt, Prizrenit, Mitrovicës së Jugut, Prishtinës, Gjakovës, Malishevës, Pejës dhe Deçanit. Burimi: <http://bitly.wws/BfKG>


⁹ Koha.net. Burimi: <https://bit.ly/3TljCJC>

Pandemia, e me pas dhe inflacioni i lartë, ka bërë që bizneset të ndërprejnë punën në terren dhe të refuzojnë kushtet e njëjta të kontratës së nënshkruar para fillimit të pandemisë. Arsyeja për këtë ishte rritja e çmimeve në treg, e cila rrjedhimisht ndikon edhe në rritjen e kostos për punët që kryhen. Kjo ka ndikuar pastaj edhe në pezullimin e kontratave ose lidhjen e kontratave me ofertues të tjerë me çmime më të larta.

2.1. Shpenzimet kapitale

Sipas kategorive ekonomike buxhetore, pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore më së shumti janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale. Nga viti 2017 deri në vitin 2021, nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar mesatarisht 15.6 milionë euro në vit. Shuma më e lartë e paguar është 20 milionë euro në vitin 2021 (38.5% e pagesave përmes vendimeve gjyqësore për atë vit), kurse shuma më e ulët e paguar është 8.9 milionë euro në vitin 2017 (77% të gjithsej pagesave përmes vendimeve gjyqësore për atë vit).¹⁰ Në vitin 2021, krahasuar me vitin 2017, shpenzimet për këtë kategori në kuadër të investimeve kapitale janë rritur për 125% apo 11.1 milionë euro.

Figura 5. Pagesat për vendimet gjyqësore dhe përmbartimore sipas kategorive ekonomike buxhetore ('000€)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat nga raportet e ZKA-së


Trendi në rritje i pagesave përmes vendimeve gjyqësore po krijon një kosto të lartë oportune për investimet publike. Mos pagesa në kohë e obligimeve ka ndikuar që pagesat të realizohen direkt nga Thesari. Kjo situatë ka rezultuar në rritjen e kostos, rrjedhimisht dëmtimin e buxhetit të shtetit. Këto pagesa përbëjnë 5% të shpenzimeve të buxhetit të realizuar për investime kapitale në vitin 2021. Sikur të mos paguheshin vendime gjyqësore, organizatat buxhetore do të mund të kryenin investime të rëndësishme kapitale në infrastrukturë, turizëm, shëndetësi dhe arsim. Sipas Ligjit të Buxhetit 2022, më shumë se gjysma e projekteve të ministrive në komuna kanë nisur në vitin 2018 dhe 2019 dhe ende nuk kanë përfunduar.¹¹

¹⁰ Zyra Kombëtare e Auditimit. Raportet Vjetore. Burimi: <https://bit.ly/3lGsbrj>; <https://bit.ly/3SbLGnC>; <https://bit.ly/3EmIiIP>

¹¹ Instituti GAP. Ligji për Buxhet 2022: Favorizimet dhe diskriminimet e komunave në investime kapitale

Parregullsitë e identifikuar nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e investimeve kapitale janë: nënshkrimi i kontratës përtej vlerës së parashikuar të buxhetit, investime publike në parcela të pa shpronësuar, mangësi në procedimin e pagesave dhe vonesa në pagesën e faturave, përzgjedhja e operatorit ekonomik të papërgjegjshëm, kryerja e pagesave për punë të porealizuara, pagesa e projekteve nga buxheti i projekteve tjera, vonesat në realizimin e punimeve, lidhja e kontratës përmes procedurës jo adekuate të prokurimit, klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, mungesë dhe mangësi në hartimin e projekteve ekzekutive për ndërtim të rrugëve, pranimi i faturës para zotimit të mjeteve financiare, etj¹²

Figura 6. Pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore për investimet kapitale ('000€)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat nga raportet e ZKA-së

2.2. Shpronësimet

Kompensimi për shpronësimet e tokave është njëra nga çështjet që ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve të shkaktuara nga vendimet e gjykatave. Gjatë vitit 2021, përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore, për çështje të shpronësimit janë realizuar pagesa në vlerë 7.4 milionë euro.¹³ Në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, pagesat përmes vendimeve gjyqësore për shpronësime janë rritur për 40% apo 2.1 milionë euro. Vlera e aplikimeve të pronarëve për kompensim të shpronësimit gjatë vitit 2020 ishte rreth 54 milionë euro, ndërsa përmes vendimeve gjyqësore janë paguar 10% e kësaj vlere. Për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga procesi i shpronësimit është përgjegjëse Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Këto pagesa bëhen nga buxheti i ndarë për investime kapitale dhe kanë të bëjnë kryesisht me prona private, shoqërore, publike dhe komunale.

Nga viti 2010 deri në vitin 2019, qeveria kishte marr vendime për shpronësime të pronave për interes publik në vlerë prej 231.7 milionë euro, ku vetëm në vitin 2019 ishin nxjerrë vendime që kapnin koston e 88.9 milionë eurove, e që duhej të kryheshin pagesat brenda dy viteve nga marrja e vendimeve. Për shpronësimin e pronave private janë shpenzuar rreth 119.4 milionë euro, për prona shoqërore 85.3 milionë euro, për prona publike rreth 15.9 milionë euro dhe për prona komunale 11.1 milionë euro.¹⁵ Në vitin 2021, obligimet financiare për shpronësimet kanë rënë në 118.3

Burimi: <https://bit.ly/3IAiN1o>

¹² Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti Vjetor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3IGsbrj>


¹³ Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin 2021. Burimi: <https://bit.ly/3k9Ssnm>

¹⁴ Kalkulim bazuar në raportet e ZKA për 11 organizatat buxhetore të cilat kishin pjesëmarrje prej 76% në shumën e përgjithshme të paguar për vendime gjyqësore dhe përmbartimore.

¹⁵ ZKA. raporti i auditimit për pasqyrat financiare të ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor 2019. Burimi: <https://bit.ly/3EiKtW8>

milione euro (61% e gjithsej obligimeve financiare të vitit 2021) nga 184.1 milionë euro sa ishte në vitin 2020.¹⁶ Një tendencë e njëjtë vërehet edhe në nëntëmujorin e vitit 2022, konkretisht periudhën janar-shator, ku pagesat për shpronësime kanë arritur vlerën e 39.4 milionë eurove, një vlerë kjo për katër herë më e lartë se në periudhën e njëjtë të vitit 2021.¹⁷ Kryerja në kohë e pagesave nga qeveria për çështje të shpronësimit, ul numrin e padive të reja dhe vendimeve të dëmshme ndaj saj, dhe rrjedhimisht, krijon mundësi për zbatim të më shumë projekteve kapitale.

Figura 7. Pagesat për shpronësime përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat nga raportet e ZKA-së

Një nga parregullsitë e identifikuar nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e investimeve kapitale janë dhe investimet publike në parcela të pa shpronësuara. Në një rast, në vitin 2016, ishte nënshkruar kontrata me operator ekonomik për punimin e rrugës 'Vojnik-Osojan', ndërsa nuk ishin bërë shpronësimet e pronave private në të cilat do të kalonte rruga. Si rrjedhojë, punimet janë ndërprerë, rruga nuk ka përfunduar dhe ka mbetur jo-funksionale. Shkak për këtë gjendje ishte edhe komunikimi jo-efektiv mes ish Ministrisë së Infrastrukturës (tani MMPHI) dhe komunave përfituese. Komunitat nuk kishin ndërmarrë asgjë për të kryer shpronësimin e trasesë së rrugës, ndërsa Ministria nuk ishte siguruar se komunitat e kanë kryer shpronësimin. Përveç kësaj, Komuna e Istogut dhe ajo e Skënderajt nuk kishin ndarë buxhet për kompensimin e pronarëve të tokave.¹⁸ Kjo, përveç që shoqërohet me vonesa në realizimin e projekteve është e mundshme të shkaktojë shpenzime shtesë të interesit si rezultat i padive nga operatorët ekonomikë.

2.3. Pagat dhe shtesat

Rritje e pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore vërehet edhe tek kategoria paga dhe shtesa. Në vitin 2021, nga paga dhe shtesa, përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore janë paguar 20 milionë euro. Në të kaluarën, pagesat për vendimet gjyqësore dhe përmbarimore në kuadër të pagave dhe shtesave kanë qenë të ulëta dhe përfshinin më së shumti deri në 3.2% të gjithsej pagesave, kurse në vitin 2021 përfshijnë 38.5% të tyre.¹⁹ Kjo rritje kryesisht është ndikuar nga vendimet për kompensimin e punëtorëve për pagat jubilarë dhe përcjellëse të cilat ishin të rregulluara sipas kontratës kolektive, por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave dhe shtesave.


¹⁶ MFPT. Raporti vjetor financiar 2021. Burimi: <https://bit.ly/414KMgY>

¹⁷ MFPT. Raporti financiar TM3 2022. Burimi: <https://bit.ly/40BBGHv>

¹⁸ ZKA. Vlera për para në ndërtimin e rrugëve lokale dhe rajonale. Burimi: <https://bit.ly/3l2i1Bp>

¹⁹ ZKA. Raportet i auditorit të përgjithshëm për raportin vjetor financiar 2021 të qeverisë për buxhetin e Republikës së Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3lGsbrj>

Figura 8. Pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përbarimore për paga dhe shtesa ('000€)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat nga raportet e ZKA-së

Shuma e përgjithshme e këtyre shpenzimeve mund të nënvlerësohet. Sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, disa institucione publike kanë klasifikuar pagesa të shumta për vendime të tilla në kategori të gabuara buxhetore. Gjatë vitit 2021, institucionet publike kanë paguar 9.3 milionë euro nga kategori ekonomike jo adekuate, prej të cilave, 1.9 milionë euro janë bazuar në vendime gjyqësore dhe përbarimore.²⁰

Kompensimi i pagave jubilarë buron nga kontratat kolektive të punonjësve të arsimit dhe shëndetësisë.²¹ Gjatë vitit 2021, për paga jubilarë janë paguar mbi 12.7 milionë euro²². Krahasuar me vitin paraprak, pagesat për paga jubilarë janë rritur për 5 milionë euro (65%). Këto pagesa realizohen nga kategoria paga dhe shtesa. Mirëpo, si rezultat i mos buxhetimit adekuat dhe mungesës së fondeve në kategorinë e pagave dhe shtesave, pagesat janë kryer edhe nga kategoritë tjera buxhetore.

Që nga nënshkrimi i kontratës kolektive mes Sindikatës së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit, dhe në mes të sindikatave të shëndetësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, komunat janë ngarkuar me pagesën e pagave jubilarë. Edhe pse nënshkruese e këtyre kontratave, Qeveria e Kosovës gjatë këtyre viteve nuk ka ndarë buxhet për këtë çështje, përkundër që në disa raste, komunat kanë bërë kërkesë ndaj MFPT. Pothuajse çdo padi e cila është paraqitur në gjykatë, vendimi final ka qenë në favor të personelit të arsimit dhe shëndetësisë.²³


²⁰ Ibid.

²¹ Ibid.

²² Kalkulim bazuar në raportet e ZKA për 11 organizatat buxhetore të cilat kishin pjesëmarrje prej 76% në shumën e përgjithshme të paguar për vendime gjyqësore dhe përbarimore.

²³ Kallxo.com. Burimi: <https://bit.ly/3ZOn2MK>

Figura 9. Pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore për pagat jubilarë



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat nga raportet e ZKA-së

2.4. Vonesat në pagesa

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, parasheh që çdo faturë e vlefshme për pagesë (mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara) të paguhet brenda tridhjetë ditëve kalendarike pas pranimit të faturës nga operatorët ekonomikë ose subjektet individuale. Gjithashtu parashihet që gjatë përgatitjes dhe miratimit të Ligjit të Ndarjeve Buxhetore për vitin aktual dhe vitet e ardhshme të sigurohen fonde dhe ndarje buxhetore të nevojshme për financimin e rregullt dhe me kohë të projekteve kapitale²⁴. Gjatë vitit 2021, sipas raporteve të ZKA të 11 organizatave buxhetore, për çështje të vonesave të faturave, përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore janë paguar rreth 11.5 milionë euro, nga të cilat, 9.5 milionë euro për vonesat që kanë të bëjnë me kategorinë e investimeve kapitale dhe rreth 2 milionë euro për vonesa që kanë të bëjnë me kategorinë mallra dhe shërbime.

Obligimet e papaguara dhe rezerva rrjedhëse

Në vitet e fundit, obligimet e papaguara kanë shënuar rritje. Obligimet e papaguara janë faturat e pranuar për punët ose shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomikë, por të cilat nuk janë paguar nga organizatat buxhetore brenda afatit të paraparë ligjor.²⁵ Obligimet financiare në vitin 2021 janë 191 milionë euro. Krahasuar me vitin 2020, obligimet financiare në vitin 2021 kanë rënë për 39% apo 127 milionë euro.

Rezerva rrjedhëse është kategori e shpenzimeve rrjedhëse. Buxheti nga rezerva rrjedhëse mund të bartet nga organizata buxhetore në kategori tjera të shpenzimeve për zbatimin e një vendimi nga autoritetet përmbarimore.²⁶ Rezerva rrjedhëse ndahet në secilin vit për secilën organizatë buxhetore të nivelit qendror dhe lokal. Kur organizata buxhetore e arsyeton propozimin për projektin kapital, mjetet nga kjo kategori mund të ndahen edhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale.


²⁴ Gazeta Zyrtare. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë . Neni 32 dhe 39. Burimi: <https://bit.ly/3lB1xcy>

²⁵ ZKA. Raporteti i auditorit të përgjithshëm për raportin vjetor financiar 2021 të qeverisë për buxhetin e Republikës së Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3lGsbri>

²⁶ Ligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Neni 15 dhe 16. Burimi: <https://bit.ly/3YrXZlJ>


Sipas Ligjit për ndarjet buxhetore vjetore, këto mjete mund të barten me aprovim të Zyrtarëve Kryesor Administrativ dhe Zyrtarëve Kryesor Financiar të organizatës kërkuese, dhe në rastet e komunave, pas aprovimit nga kuvendi komunal.

Figura 10. Detyrimet e papaguara (2017–2021)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat nga Raportet e ZKA-së


Figura 11. Komunat me obligimet më të larta buxhetore



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat nga Raportet e ZKA-së

Gjatë periudhës 2017–2022, për kategorinë e rezervës rrjedhëse mesatarisht janë buxhetuar 17.1 milionë euro. Buxheti për rezerva rrjedhëse në vitin 2022 ishte rreth 21.1 milionë euro. Detyrimet e papaguara në shumë raste shoqërohen me shpenzime shtesë nga vendimet gjyqësore dhe përmbarimore. Në raport me pagesat, sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore, për vitin 2022 nga rezervat rrjedhëse ofrohet 45% mbulueshmëri. Ndërsa, krahasuar me vitin 2021, për vitin 2022, mbulueshmëria e pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore nga rezervat rrjedhëse ka rënë nga 65% në 45%. Kësisoj, kjo ndikon që të rriten edhe detyrimet kontingjente, por edhe të merren fonde nga linja tjera buxhetore.

Figura 12. Rezervat rrjedhëse (2017–2022)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e ZKA dhe MFPT

Përfundim

Gjatë viteve 2017–2022, institucionet publike kanë realizuar çdo herë e më shumë pagesa përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore, të cilat janë përcjellur edhe me shpenzime shtesë të interesit. Thesari i Kosovës, duke u bazuar në vendimet e gjykatave për vitin 2022, ka realizuar pagesa nga buxheti i institucioneve publike në vlerë prej 46.3 milionë euro. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2022, pagesat janë ulur për rreth 5.6 milionë euro apo për (-11%). Mjetet e ndara tek rezerva rrjedhëse në vitin 2022 ishin të pamjaftueshme për ti mbuluar pagesat për vendimet gjyqësore dhe përmbarimore. Çështjet të cilat i shkaktojnë këto pagesa kryesisht kanë të bëjnë me procese të shpronësimit, paga jubilarë dhe vonesa në pagesa të faturave. Gjatë viteve 2017–2022, pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore, më së shumti kanë ndodhur tek kategoria e investimeve kapitale, duke përfshirë këtu kompensimet për shpronësimet e tokave dhe vonesat në pagesa. Mirëpo, në dy vitet e fundit, përfshi këtu dhe nëntëmujorin e vitit 2022, pagesat e bëra nga organizatat buxhetore për çështjet e shpronësimit janë rritur. Konkretisht, gjatë nëntëmujorit të vitit 2022 ato janë katërfishuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Si rrjedhojë, kjo ndikon që të ulet numri i padive të reja dhe vendimeve të dëmshme gjyqësore me ndikim buxhetor. Edhe vlera e obligimeve financiare nga faturat e papaguara, ndonëse mbetet në një nivel të lartë prej rreth 191 milionë eurove, gjatë vitit 2021 ajo ka rënë për 39% apo 127 milionë euro krahasuar me vitin 2020.

Por, së fundmi, rritje e pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore vërehet edhe tek kategoria paga dhe shtesa, kryesisht për shkak të pagave jubilarë që burojnë nga kontratat kolektive të punonjësve të arsimit dhe shëndetësisë. Po ashtu, shuma e detyrimeve kontingjente, të cilat rrezikohen të shpenzohen me vendime të gjykatave, është rritur gjatë vitit 2022 për rreth 110 milionë euro, duke e arritur vlerën totale të 347 milionë eurove.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në vitin 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtine

+383 38 609 339

info@institutigap.org

Instituti GAP mbështetet nga:



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World

Ky projekt është mbështetur nga



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden
Sverige

